



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-12830/23 datë: 23.05.2023



Npi – 01/206 datë: 31.05.2023

Duke u bazuar në nenin 12 pika (d) dhe 68.3 dhe 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Nr.03-L-048; Nenit 8 të Rregullores Komunale për Transparencë 01Nr.06/361/4, datë: 04.03.2009; Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023. Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më: 31.05.2023 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR DISKUTIM PUBLIK
TË DRAFT KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE TË KOMUNËS SË SHITES
PËR PERIUdhËN 2024-2026

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -V- të rregullt për vitin 2023, të mbajtur më 31.05.2023, unanimisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Shtimes për periudhën 2024-2026, për afatin prej 15 ditësh. Bartës të organizimit të aktiviteteve për procesin e diskutimit publik është Zyra Komunale e Financave, Komiteti për Politikë dhe Financa, si dhe Zyra për Informim.

II

Vendimi është aprovuar duke marrë parasysh edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Zyrës Komunale për Financa, Drejtorive , Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi